



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

V E N D I M

Nr.79 Datë 2. 05. 2008

Për

Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të përbashkët mbi pjesën prej 67 % të kapitalit aksionar në Media Vizion Sh.A nga shoqëritë Spot AG & Ost'holding GmbH

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali Zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 2. 05.2008, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të përbashkët mbi pjesën prej 67 % të kapitalit aksionar në Media Vizion Sh.A nga shoqëritë Spot AG & Ostholding GmbH

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, neni 56, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” neni 5.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të informacionit të Sekretariatit mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të pjesës prej 67% të kapitalit aksionar në shoqërinë Media Vizion Sh A, nga shoqëritë Spot AG dhe Ost Holding GmbH.

V Ë R E N S E:

1. Palët e përfshira në mënyrë të drejtëpërdrejtë në transaksion:

1.1 Media Vizion Sh A me qendër në Tiranë, Shqipëri, e licensuar për ofrimin e shërbimeve radio-televizive, në tregun kombëtar, është **shitësi** i pjesës prej 67% të kapitalit aksionar të shoqërisë;

1.2 - Spot AG, me qendër në Vienë, Austri, me veprimtari shitblerje dhe administrim aksionesh, dhe

- Ost Holding GmbH, me qendër në Vienë, Austri, me veprimtari shitblerje dhe administrim aksionesh;

janë **blerësit/përftuesit e kontrollit** për pjesën 67% të kapitalit aksionar në shoqërinë Media Vizion ShA.

2. Marrëveshja e shitblerjes, e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në datën 20 Mars 2008, ka për objekt përftimin e kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Ost Holding dhe Spot AG, nëpërmjet blerjes së 67% të kapitalit aksionar në shoqërinë Media Vizion Sh.A është njoftuar në Autoritetin e Konkurrencës në datën 28.03.2008, në përputhje me afatin ligjor të parashikuar në nenin 12, pika 2 e Ligjit.

3. Ky transaksion që realizon në mënyrë të drejtëpërdrejtë "*përftimin e kontrollit*", në kuptim të nenit 10, pika 1 dhe 2, konsiderohet si përqendrim.

4. Transaksion duhet t'i nënshtrohet procedurës së kontrollit të përqendrimit të parashikuar në Kreun e IV të Ligjit, me kusht që ky të përmbushë në mënyrë kumulative edhe kushtin e parashikuar në pikën 1, shkronja a) dhe b) të nenit 12 të Ligjit.

5. Xhiro totale e palëve blerëse në tregun ndërkombëtar:

- për vitin 2006 është: 561, 4 milion lekë
- për vitin 2007 është 976,5 milion lekë; dhe

Xhiro totale e shitësit në tregun e brendshëm:

- Për vitin 2006 është: 157 milion lekë
- Për vitin 2007 është: 295.3 milion lekë

6. Referuar informacioneve për xhiron ndërkombëtare dhe atë kombëtare të realizuar për vitin paraardhës të transaksionit dhe deklaruar nga palët pjesëmarrëse, transaksioni i njoftuar nuk plotëson kushtin e parashikuar në nenin 12, pika 1 e ligjit

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, nenit 5 të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”

VENDOSI:

1. Njoftimi i përqendrimit “Për përfitim të kontrollit të përbashkët mbi 67% të kapitalit aksionar në shoqërinë Media Vizion ShA, me seli në Shqipëri, nga shoqëritë Spot Holding AG dhe Ost Holding GmbH, me seli në Austri, për shkak të mosplotësimit të kritereve të përcaktuara në nenin 12, pika 1 shkronjat a) dhe b) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, nuk konsiderohet përqendrim që duhet të autorizohet nga ana e Komisionit të Konkurrencës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

()
Zv/Kryetar

Servete Gruda

()
Anëtar

Koço Broka

()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R